

# Ardiani, Drita dhe të tjerët...

Çfarë duhet të bëni kur e keni fëmijën të sëmurë.

Dr. Isabelle Germann-Nicod e  
Dr. Josiane Racine-Stamm



ssp sgp

SWISS SOCIETY OF PEDIATRICS  
Ihre Ärztinnen und Ärzte für Kinder und Jugendliche  
Les médecins de vos enfants et adolescents  
I medici dei vostri bambini e adolescenti

Shoqata zvicerane e Pediatriisë: [www.swiss-paediatrics.org](http://www.swiss-paediatrics.org)

Këtë broshurë mund ta porositni në adresën që vijon:  
Stiftung Schulungs- und Wohnheime Rossfeld  
Reichenbachstrasse 122, Postfach 699, 3004 Bern 4  
[buerozentrum@rossfeld.ch](mailto:buerozentrum@rossfeld.ch), Fax 031 300 02 99

<b>Hyrje</b>	faqe 4
<b>Kutia e ndihmës së shpejtë</b>	faqe 5
<b>Duhet mbikqyrur</b>	
• Temperatura	faqe 6
• Kllapia prej etheve	faqe 8
• Kolla	faqe 9
• Dhembjet e grykës	faqe 12
• Dhembjet e veshit	faqe 14
• Shpërthimi i puçrave	faqe 16
• Gëlltitja e ndonjë sendi	faqe 17
• Kafshimet prej kafshëve	faqe 18
• Pickimet nga insektet	faqe 19
• Goditjet në kokë	faqe 20
• Të vjellat	faqe 21
• Diaretë	faqe 23
• Dhembjet e barkut	faqe 25
• Hernia (të rrënxuarit)	faqe 26
• Kapsllëku	faqe 27
<b>Urgjencat</b>	
• Zënia e frymës	faqe 28
• Kllapia	faqe 30
• Koma	faqe 31
• Intoksikimi (helmimi)	faqe 32
• Aksidentet:	faqe 34
– djegiet	faqe 35
– zënia e korrentit	faqe 36
– mbytja në ujë	faqe 37
<b>Fëmija që ushqehet me gji nga 0 deri në 3 muaj</b>	faqe 40

Drita duket e sëmurë. Diçka ju shqetëson tek Ardiani? Para se të vraponi te telefoni për të thirrur pediatrin (mjekun e fëmijëve), lexoni këtë broshurë; në të do të gjeni këshilla praktike se si duhet të veproni aty për aty.

**Një këshillë për ju: që të mund ta përdorni sa më mirë këtë broshurë aty për aty, lexojeni atë PARA se të keni nevojë për të.**

Në kreun e quajtur «**Duhet mbikqyrur**» përshkruhen problemet më të shpeshta e përgjithësisht «**pa rrezik**»

Në kreun «**Urgjenca**» (raste të ngutshme) shpjegohen situatat, të rralla në të vërtetë, që kërcënojnë jetën dhe që kërkojnë ndërhyrjen e shpejtë të pediatrit.

Rubrika «**Çfarë duhet bërë së pari?**» thotë se si duhet të veproni aty për aty (keni apo nuk keni nevojë për mjekun), pastaj brenda kuadratit mund të gjeni vendimin që duhet të merrni sipas shkakut të problemit dhe gjendjes së fëmijës.



ju sinjalizon se duhet thirrur mjeku qoftë për të marrë udhëzime, qoftë për të caktuar një takim jo urgjent me të.




tregon se duhet shkuar me urgjencë te mjeku, madje se duhet shkuar drejt e në spital me mjetin e vet të transportit (por jo vetëm me fëmijën në veturë) ose me makinën e ambulancës.

# Kutia e ndihmës së shpejtë e familjeve me fëmijë

A keni gjithçka që duhet për t'u kujdesur për fëmijët tuaj?  
Ja materiali minimal që duhet ta keni gjithmonë në kutinë tuaj të ndihmës së shpejtë (apo që duhet ta merrni me vete kur shkoni me pushime). Tregojani atë edhe personit që mban fëmijët tuaj.

- Lëng për dizinfektimin e plagëve
- Fasho ngjitëse
- Shirit elastik
- Ilaçe kundër etheve (temperaturës).
- Shumica e tyre janë të efektshme edhe kundër dhëmbjes (Shih tabelën e dozave faqe 6).
- Termometër
- Produkt për rihidratimin e trupit në rast diareje (heqie barku) ose të vjellash (GES 45 për sh.)
- Ilaç me pika për hapjen e hundës dhe serum fiziologjik për pastrim



Vini Re: Të paktën një herë në vit, verifikoni afatin e vlefshmërisë së produkteve.



## **Temperatura** (kjo nuk ka të bëjë me fëmijët e vegjël)

Temperatura, edhe kur është e lartë, nuk është detyrimisht shenjë e seriozitetit të sëmundjes dhe nuk e dëmton trurin. Në shumicën e rasteve, ajo shkatohet nga «gripi» dhe mund të vazhdojë deri në 72 orë. Fëmija juaj ka ethe (zjarr)... po sa e ka temperaturën? **Merrjani** temperaturën në rektum (ose përdryshe nën sqetull).

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. **Kur temperatura është nën 38 gradë (në rektum):** nuk ka asgjë serioze; merrjani përsëri temperaturën pak më vonë.

**Kur temperatura është nga 38 deri në 38,5 gradë:** zhvisheni fëmijën dhe lereni me tashat e brendshme në dhomë të freskët. Teshat e tepërta ose hedhja e një mbulese e rrisin temperaturën.

**Kur temperatura është mbi 38,5 gradë:** Sidomos në rast se fëmija është nën 4 vjeç, përpiquni t'ia ulni temperaturën; që ai të ndjehet mirë dhe që të shmangët rrënia e mundshme e tij në kllapi (shih f. 8). Jepini paracetamol, që shitet me emra të ndryshëm (si Benuron, Dafalgan, Tylenol, etj.). Dozazhi është rreth 10 miligramë për çdo kilogram të peshës së fëmijës (për shembull: 80 miligramë për peshën 8 kilogramë). Të njëjtën dozë duhet t'ia jepni përsëri çdo 6 orë, nëse temperatura vazhdon të jetë mbi 38,5.

Poqese temperatura, pavarësisht nga trajtimi i bërë, mbetet e lartë apo ngrihet shpejt e ju nuk doni të prisni 6 orë, eventualisht mund të përdorni kompresat me ujë të ftohtë rreth kofshëve dhe këmbëve.

Mund t'ia jepni edhe ndonjë tip tjetër ilaçi kundër temperaturës, d.m.th. ndonjë ilaç kundër përskuqjes (si Brufen, Méfénacide, Mephadolor, etj.), në marrëveshje me mjekun dhe sipas dozazhit të këshilluar.

**Vini re:** paracetamoli dhe ilaçet kundër përskuqjes janë të efektivë edhe kundër dhembjes.

**Vini re:** acidi acetil-salicilik (Aspirina) nuk këshillohet nën moshën 12 vjeç dhe nuk përdoret në rast varicele.

Nëse temperatura i ringrihet dhe i kalon 38,5 gradë, bëni përsëri të njëjtat veprime, por mos e kaloni dozën e ilaçeve të këshilluara.

# Duhet mbikqyrur

2. *Është gjithashtu e rëndësishme që fëmijës t'i jepni shpesh për të pirë. Është më mirë t'i jepni fëmijës ujë, çajra për fëmijë të vegjël ose lëngje të tjera të ngrohta (si lule bliri, kamomil, etj.), sesa t'i jepni qumësht apo lëngje frutash (që u shkaktajnë të vjella).*
3. *Mbikqyreni gjendjen e fëmijës; nëse fëmija ecën e luan dhe fytyrën e ka të kuqe, ka pak gjasa që ai të ketë ndonjë sëmundje të rëndë.*



Nëse fëmija është i zbehtë ose nuk tregon interes për mjedisin përreth

Nëse ka njolla mbi lëkurë

Nëse ka dhembje të mëdha në grykë (fyt), ka jargë dhe i zihet fryma

Nëse ka shumë kollë dhe e ka frymëmarrjen shumë të shpeshtë

Nëse ka dhembje koke, nuk mund ta përkulë zverkun dhe ka të vjella

Nëse ka edhe shenja të tjera shqetësuese

**Tërrisni 144-ën.**



Nëse ethet i zgjasin më shumë se 3 ditë

Nëse ethet i shfaqen shumë ditë pas fillimit të rrufës ose kollës

Nëse ethet shoqërohen me dhembje gryke, dhëmbje veshi, apo me dhembje barku dhe me simptoma (shenja) urinare

**Kontakttoni pediatrin brenda gjysmë-ditës.**

Vini Re: Nxjerrja e fëmijës me ethe për ta çuar te mjeku nuk është e rrezikshme; përkundrazi kjo ndihmon në uljen e temperaturës së tij.

## Kllapia prej etheve

Kllapia u ndodh fëmijëve të moshës nga 6 muaj deri në 6 vjeç, në rast ngritjeje të shpejtë të temperaturës (për shembull kur kalojnë gripin). Megjithëse lë përshtypje të madhe, ajo nuk shkakton dëmtime në tru. Në shumicën e rasteve, ajo ndalet vetvetiu pas disa minutave. Fëmija humbet ndjenjat (sytë i kthehen përbrenda), ai bëhet i squllët ose i ngurtësuar, bën lëvizje ritmike me gjymtyrë.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Ruani gjakftohtësinë
2. Mos e lini fëmijën të lëndohet
3. Kthejeni në brinjë dhe zhvisheni
4. Uljani temperaturën; por mos i jepni kurrgjë nga goja, nëse fëmija është pa ndjenja



Nëse fjala është për kllapinë e parë prej etheve, thërrisni pediatrin me urgjencë.

Në raste të rralla, në fakt, kjo është simptomë e meningjtit.

Nëse kllapia zgjat më shumë se 10 minuta, thërrisni 144-en.



Nëse fëmija ka rënë edhe më parë në kllapi nga ethet dhe gjendja e tij është e mirë, lajmëroni pediatrin brenda gjysmë-ditës.

## Kolla

Kolla është një refleks i dobishëm për hapjen e rrugëve të frymëmarrjes.

Ajo ka shumë shkaqe të mundshme.

Në shumicën e rasteve, ajo shkaktohet nga irritimi i grykës i bërë prej një virusi dhe theksohet prej sekretimeve të rrufës. Fëmija kollitet më shumë kur është i shtrirë, sesa kur është në këmbë, por merr frymë rregullisht në intervalet midis krizave.

Nganjëherë, shkaku është një laringjit, përskuqje virusale e organit të zërit; kjo ndodh shpesh në moshën nën 5 vjeç; i sëmuri zgjohet natën nga një kollë e fortë dhe e persëritur; ai e humbet zërin; nganjëherë ka zorr të marrë frymë; ajri hyn keq.

**Astma**, përskuqje e bronkeve (ndodh rallë në moshën nën 5 vjeç), dhe **bronkioliti**, infeksion viral e bronkeve të vogla (ne përgjithësi para moshës 2 vjeçare), gjithashtu janë shkaktarë të kollës; frymëmarrja është pak a shumë e vështirë, ajri del keq dhe bën një fishkëllimë që dëgjohet.

Më në fund, vjen **bronkiti** ose **pneumonia** (infektim i bronkeve ose i mushkrive) janë gjithashtu shkaktarë të kollës; në këtë rast trymëmarrja është e shpejtë, fëmija ka temperaturë.

### **Çfarë duhet bërë më parë?**

1. Në rast rrufe, ngrejani kokën lart; bëni avull me aparat humidifikator; i hidhni pika në hundë.
2. Në rast laringjiti, uleni fëmijën në banjë dhe hapni në maksimum robinetat për të bërë sa më shumë avull, ose vendosni një aparat humidifikator të mirë (po qe e mundur me avull të ftohtë) në dhomën e tij.
3. Nëse fjala është për bronkiolit, bëni sa më shumë avull përreth të sëmurit.
4. Në rast astme, i jepni barnat e dhëna me recetë prej mjekut.
5. Në të gjitha rastet, i jepni për të pirë sa më shpesh sasi të vogla uji, çaji të zi të lehtë ose tizanë.

# Duhet mbikqyrur



Nëse fëmija flë keq,

Nëse kolla vazhdon prej më shumë se 10 ditësh,

Nëse ajo shoqërohet nga ethe gjatë më shumë se tri ditë apo me frymëmarrje të shpejtë apo me dhembje në toraks,

**Kontaktoni pediatrin.**



# Duhet mbikqyrur



Nëse fjala është për laringjit dhe gjendja e të sëmurit nuk përmirësohet pas 15 minutash avulli intensiv,

Nëse fëmija kalon një krizë astme për herë të parë (apo nëse kurimi është i paefektshëm),

Nëse ka gëlltitur një send të vogël që i ka ngecur keq,

Nëse ka jargë të shumta dhe ka shumë dhëmbje në grykë,

**Thërrisni 144-ën.**

(Shih edhe Zënia e Frymës f. 28)



Shmangni ekspozimin e fëmijës në tymin e duhanit.

Kujdes që fëmija të mos bjerë mbi aparatit humidifikator me avull të nxehtë: sepse ilaçi do të ishte më i keq se sëmundja.

## Dhembjet e grykës

Kur fëmija ankohet se ka dhëmbje në grykë; temperaturën e ka 38,4 gradë: çfarë mund të ketë vallë?

Në 80 % të rasteve, dhëmbja e grykës shkaktohet nga «**angina**» **virale** dhe shoqërohet shpesh me rrufë, sy të irrituar, eventualisht me kollë, ethe.

Por mund të jetë edhe simptoma e një **angine me Streptokok**, mikrob që duhet trajtuar me **antibiotikë** për të parandaluar komplikimet e mëvonshme serioze. I sëmuri në përgjithësi ka temperaturë të lartë, vjell shpesh; mund të ketë edhe puçra ngjyrë trëndafili-të kuqe: fjala është për skarlatinën.

Më në fund, në raste të rralla, mund të bëhet fjalë për infektimin e epiglotës (gjuhëzës). (Shih f. 28)



# Duhet mbikqyrur

## Çfarë duhet bërë së pari ?

1. Nëse fëmija është mbi 4 vjeç, ju mund t'i jepni të thithë tableta për qetësimin e dhembjes.
2. Trajtojini ethe nëse ka, me paracetamol (shih dozazhin f. 5)
3. Jepini për të pirë lëngje të ëmbla e të frohta (JO lëngje frutash apo limonada që ngacmojnë grykën, as qumësht që mund të shkaktojë të vjella).
4. Vëzhgojeni fëmijën.



Nëse fëmija ka ethe ose shpërthim puçrash, por përndryshe është mirë,

**thërrisni në kabinetin e pediatrit për t'u siguruar se nuk ka anginë me Streptokok.**



Nëse fëmija ka **SHUME** dhembje, nuk mund të kapërdijë lëngjet, ka jargë të shumta dhe ka zorr në frymëmarrje,

**mbajeni ULUR dhe thërrisni 144-ën për të shkuar në spital.**

## Dhembjet e veshit

Siç i ndodh shpesh, fëmija juaj ka rrufë; por ai zgjohet nga një dhembje e fortë në vesh që nuk i ikën më; temperatura e tij deri atëherë 37,8 gradë ngjitet në 38,5 gradë; me siguri ai ka një **otit** akut. Otitet, infeksione me mikrobe i timpanit dhe i kavitetit që ndodhet prapa, janë komplikime të shpeshta të rrufës te fëmija. Simptomat e zakonshme janë: **dhembja** (por ajo edhe mund të mungojë apo të mos jetë e dukshme te fëmija e vogël), **ethet** (edhe ato mund të mungojnë), diaretë ose të vjellat (sidomos te fëmija në moshë të vogël) dhe rrjedhja e një lëngu të bardhë-limon nga veshi, kur timpani është i çarë.

### Çfarë duhet bërë së pari?

1. Mateni temperaturën e fëmijës.
2. Nëse fëmija ka ethe dhe vuan, i jepni atij një ilaç për uljen e temperaturës (shih f. 5)
3. Shikoni në se ka rrjedhje nga veshi.
4. Mos vini asgjë në vesh pa këshillën e mjekut.



Nëse fëmija është mbi 2 vjeç e nuk ka ethe,

Nëse dhembja është pak e fortë dhe me ndërprerje,

mund të vëzhgoni evoluimin gjatë një periudhe prej 24 deri në 48 orë, **para se eventualisht t'i telefononi pediatrit.**

# Duhet mbikqyrur



Nëse fëmija është nën 2 vjeç, nëse është i zbehtë dhe i irritueshëm ose fut gishtin në vesh,

Nëse dhembja është e fortë, e vazhdueshme, dhe nuk qetësohet nga trajtimi i dhënë më parë,

Nëse veshi i rrjedh (ngjyrë të bardhë – të verdhë),

Nëse pjesa pas veshit është e kuqe ose e fryrë,

Nëse disa ditë pas fillimit të rrufës fëmija është më keq ose ka ethe,

**Thërrisni mjekun shpejt.**



Disa lloje otitesh mund të shmangen te fëmija i vogël duke mos e lënë atë të pijë bibëronin i **shtrirë** (por duke ia dhënë atë në pozicionin ulur).



## Shpërthimet e puçrave, puçrat

Shpërthimet e puçrave te fëmijët janë shumë të shpeshta. Mund të shihen kur kanë ose nuk kanë ethe.

Shkaqet e tyre janë të shumta, vijnë nga sëmundje fëminore ose nga ekzema.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Merrni temperaturën rektale.
2. Verifikoni nëse fëmija ka sjellejen e tij të zakonshme.
3. Vëzhgoni gjendjen e fëmijës, a paraqet ajo simptoma të tjera?



Nëse fëmija ka një shpërthim puçrash me temperaturë të moderuar dhe gjendja e tij është e mirë,

**Thërrisni pediatrin.**



Nëse fëmija ka një shpërthim puçrash ngjyrë vjollcë me temperaturë të lartë dhe gjendja e tij keqësohet me shpejtësi,

**Thërrisni 144-en.**

## Gëllitja e ndonjë sendi

Gjatë kohës që ju përgjigjeshit në telefon, fëmija kapërdiu një karficë... Mos kini frikë! Në shumicën e rasteve, sendi, edhe nëse është me majë ose i mprehtë del pa problem nga ana tjetër e sistemit tretës!

### ***Çfarë duhet bërë së pari?***

1. *Mbikqyrni gjendjen e fëmijës: a vjell ai? A ka dhembje barku?*
2. *Vëzhgoni ujin e trashë të tij: do të lehtësoheni kur në oturak do të gjeni sendin në fjalë.  
Shikoni gjithashtu nëse ngjyra e tij është si zakonisht.*



Nëse sendi është i madh,

Nëse fjala është për një bateri (pilë),

Nëse fëmija vjell ose ka dhembje barku,

Nëse uji i trashë i tij është ngjyrë në të zezë

**Thërrisni mjekun me urgjencë.**



Kujdes, fëmijët e vegjël kanë prirje ta vënë në gojë për ta «shijuar» çdo gjë që gjejnë. Prandaj mos lini sheshit monedha, bateri makinash llogaritëse, gjilpëra e karfica, as sende të tjera të vogla.

Sendi i gëlltitur mund të shkojë edhe në rrugët e frymëmarrjes, gjë që është më e rrezikshme (shih f. 28) dhe sjell turbullira në frymëmarrje.

# Duhet mbikqyrur

## Kafshimet prej kafshëve

Fëmija mund të kafshohet qoftë prej një kafshe shtëpiake (p.sh.: qeni, hamsteri (miu) etj. ...), qoftë prej një kafshe të egër.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Ruani qetësinë.
2. Lajeni plagën me ujë të bollshëm dhe me sapun gjatë 15 minutave pastaj dezinfektojeni atë me alkool.
3. Duhet të informoheni për të mësuar:
  - **në rast kafshimi prej një kafshe shtëpiake:** nëse fëmija është vaksinuar si duhet kundër tërbimit.
  - **Në rast kafshimi prej një kafshe të egër ose endëse:** se për cilën kafshë bëhet fjalë (madje të tentoni edhe ta kapni atë... po të jetë e mundur).



Në të gjitha rastet, thërrisni pediatrin i cili do t'ju thotë masat që duhen marrë (përfshirë edhe ribërjen e gjilpërës kundër tetanosit).



# Duhet mbikqyrur

## Pickimet nga insektet

Fëmija mund të ketë reagime të dhembshme dhe të dhunshme pas pickimit prej një insekti.

### *Çfarë duhet bërë së pari?*

1. Qetësojeni fëmijën.
2. Dezinfektoni vendin e pickimit dhe vendosni mbi të akull.
3. Hiqni thumbin (nëse fjala është për pickim nga bleta).
4. Nëse dhembja është e fortë, i jepni një ilaç kundër dhembjeve (shih f. 5).



Nëse fëmija pickohet në gojë ose në grykë,

Nëse paraqet shenja të përgjithëshme (skuqje të përgjithësuar, vështirësi për të marrë frymë ose për të kapërdirë ushqimin, ethe, fryrje, ndjehet keq ose humbet ndjenjat),

**Thërrisni 144-ën.**



## Goditjet në kokë

Nëse traumatizmat e kokës janë të shpeshta te fëmijët, shumica e tyre nuk janë serioze: në shumicën e rasteve në vendin e goditjes krijohet një gungë, e cila nuk është e rrezikshme.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Vini ujë të ngrirë mbi gungë.
2. Vëzhgojeni fëmijën dhe sigurohuni se ai ka sjellje normale gjatë orëve dhe ditëve të mëpasme.



**Fëmijën duhet ta shpini shpejt në spital, eventualisht me ambulancë (tel. 144).**

Nëse humbet ndjenjat në çastin e goditjes

Nëse ka rrjedhje gjaku ose i del gjak nga hunda, veshët apo goja

Nëse ka ndryshim në sjellje

Nëse vjell më shumë se 2 herë pas goditjes

Në se bebëzat e tij (pjesa qendrore e zezë e syrit) kanë madhësi të ndryshme

## Të vjellat

Të vjellat janë nxjerrja jashtë me forcë e një sasive TE MADHE lëngu ose ushqimesh nga stomaku. Kjo është simptomë problemesh të ndryshme, në shumicën e rasteve jo të rrezikshme (si gripi, mostretja, zënia e makinës), por edhe më serioze (gastro-enterit, infeksion urinar, etj.).

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Mos i jepni më fëmijës ushqim të thatë
2. I jepni të pijë një produkt për rihidratim (GES për sh.), me sasi të VOGLA dhe SHPESH HERE (çdo 15 minuta për fëmijët nën 2 vjeç. Këto të fundit nuk i duhen dhënë më shumë se gjatë 24 orëve. Qumështi dhe lëngjet e frutave nuk këshillohen. (shih edhe f. 23).
3. Verifikoni në se fëmija ka ethe, e nëse ka, uljani atë. (shih f. 5).
4. Vëzhgoni shfaqjen e simptomave të tjera si: diareja, dhembja e kokës, dhembjet e barkut dhe dhembjet kur urinon, etj.



Nëse bëhet fjalë për një fëmijë që ushqehet me gji

Nëse fëmija është nën 2 vjeç dhe ka edhe diare të lëngshme

Nëse të vjellat vazhdojnë edhe pas 6 orësh, pavarësisht nga trajtimi i bërë si më sipër

Nëse fëmija ankohet se ka dhembje në bark dhe kur bën urinën

**Thërrisni pediatrin.**



Nëse fëmija ka ethe dhe dhembje të forta koke

Nëse vjell gjak

Nëse i sëmururi ka dhembje në bark që sa vijjnë e shtohen, (pikërisht në anën e djathtë)

Nëse del jashtë ngjyrë të zezë apo me gjak

Nëse ka pësuar një goditje të fortë mbi kafkën e kokës më përpara

**Thërrisni mjekun me urgjencë ose shkoni në spital.**

Nëse urinon pak, më pak se një herë në 8 orë, dhe nuk reagon,

**Thërrisni 144-ën.**

Vini re: I jepni ushqime të forta (e pa yndyrë) vetëm kur fëmija të mos ketë më neveri: Mos u shqetësoni nëse të vjellat shkaktohen prej kollës, kur fëmija është mbi 6 vjeç.

## Diaretë

Fjala është për dalje jashtë **të lëngshme** e të **shpeshta**.

Në shumicën e rasteve, diaretë shkaktohen prej një virusi: flitet për «grip intestinal» (i zorrëve): ato vazhdojnë 3 deri në 5 ditë dhe mund të shoqërohen nga ethe e të vjella. Fëmija rrezikon atëherë të **chidratohet** (të humbë lëngjet e trupit), sidomos nëse është nën 2 vjeç.



## Çfarë duhet bërë së pari?

1. Të sëmurit, i duhet dhënë shumë për të pirë:  
**Nëse fëmijës i jepni gjirin**, vazhdoni; jepini atij edhe produkte rihidratimi, p.sh. GES 45 (shih skemën e mëposhtme),  
**Nëse fëmija pi qumësht (pluhur apo të lëngshëm) me biberon**, ndaljami gjatë 4 deri në 6 orë; e gjatë kësaj kohe jepini të pijë edhe ndonjë produkt rihidratimi, p.sh. GES 45 (si në skemën e mëposhtme),
2. Nëse fëmija tashmë ha ushqime **të forta** (dhe nuk vjell), parapëlqeni patatet, drithërat; bukën, orizin për më të rriturit, si dhe mishrat jo të majmë, frutat (bananet, mollët) dhe perimet e ziera (karotat); pasi t'i keni dhënë gjithashtu shumë për të pirë (shih skemën).

### Skemë rihidratimi

**Gjatë 4 orëve të para**, jepini 50 ml lëng për çdo kilogramë të peshës së fëmijës (për shembull: 300 ml nëse ai peshon 6 kg), shpesh e me sasi të vogla (edhe sikur të vjellë).

**Pas 4 deri në 6 orë**, jepini 100 ml pas çdo diareje, nëse ajo vazhdon ...



Nëse diaretë janë shumë të shpeshta (më shumë se 4–5 në ditë) dhe fëmija është i vogël (nën 2 vjeç)

Nëse përmbajnë gjak

Nëse fëmija nuk pranon të pijë ose vjell çdo gjë që pi

**Thërrisni mjekun me urgjencë.**

Nëse urinon pak (më pak se një herë në 8 orë) dhe është tepër i qetë

Nëse fëmija është në gjendje të përgjithëshme të keqe, apo ka shumë ethe, edhe nëse diaretë janë në sasi të vogël

**Thërrisni 144-ën.**

Vini re: të dalat jashtë janë normale te i sapolinduri që ushqehet me gjirin e nënës.

Vini re: Skema e rihidratimit zbatohet edhe në rast vjelljesh të izoluara por të shpeshta.

## Dhembjet e barkut

Dhëmbjet e barkut kanë origjinin të ndryshme të fëmija: gripi, angina, infeksioni urinar ose tretës, kapsllëku, apendiciti dhe gjithashtu tendosjet psikologjike mund të jenë shkaktarë të tyre.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

*Në rast dhembjeje të madhe:*

1. *Shtrijeni të sëmurin në një vend të qetë,*
2. *Verifikoni temperaturën e tij dhe kuroni ethet në se ka,*
3. *I jepni për të pirë sasi të vogla lëngjesh me sheqer,*
4. *Mos i jepni ushqim të fortë gjatë disa orëve.*



Nëse ka diare, ethe dhe/ose vjell,

Nëse fëmija ka dhembje kur urion,

Nëse ka një bulë në të thelluarën e kofshës (hernie/të rrënxuarit, shih f. 26)

Nëse dhembja është e fortë, e vazhdueshme ose ndodhet në anën e djathtë,

Nëse fëmija paloset më dysh prej dhembjes,

### **Thërrisni pediatrin me urgjencë.**

Nëse gjendja e përgjithëshme e tij është e keqe: fëmija është i zbehtë ose përkundrazi shumë i kuq, dhe i ka humbur fuqinë.

**Thërrisni 144-ën.**

## Hernia/të rrënxuarit

Duke e ndërruar fëmijën 3 muajshe, ju shikoni një «bulë» në të thelluarën e kofshës, sipër testikulave të djemtë dhe të buzëve të mëdha të vajzat: ka të ngjarë që fjala të jetë për hernie: zorra duket poshtë lëkurës, për shkak të dobësisë së muskujve të barkut.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. *Përpiquni ta qetësoni fëmijën, nëse ai qan; shpesh hernia zhduket kur fëmija qetësohet, pikërisht kur bën banjë. Ajo mund të ridalë më vonë; por herina që hyn e del në përgjithësi nuk paraqet ndonjë problem urgjent.*
2. *Mos u orvatni ta fusni hernien brenda, nëse nuk keni përvojë, e mos improvizoni duke përdorur fashim kompresiv që mund ta keqësojë më shumë gjendjen.*



Nëse zbuloni një hernie për herë të parë, **merrni në telefon pediatrin, me qëllim që ai t'a konfirmojë diagnozën.**



Nëse hernia është shumë e fortë, ngjyrë vjollcë (hernie e «mbytur»)

Nëse fëmija qan gjatë shumë orëve dhe hernia duket e dhembshme

Nëse ai vjell

**Thërrisni mjekun me urgjencë ose shkoni drejtpërdrejt në spital.**

Vini re: shpesh të fëmijët që ushqehen me gji ekziston një bulë në nivelin e kërthizës: kjo është hernie kërthizore; këto hernie nuk «mbyten» gati asnjëherë dhe rallë duhen operuar, me përjashtim të rasteve kur ato janë shumë të mëdha (të voglat zhduken me moshë).

## Kapllëku

Ai përcaktohet prej daljes jashtë shumë rrallë e tepër të fortë. Shumicën e herëve, ai nuk shkaktohet nga ndonjë sëmundje, por është me origjinë ushqimore ose psikike.

### *Çfarë duhet bërë së pari?*

1. Përdorni mjete të thjeshta, si lëngje frutash, ushqim të larmishëm: fruta, perime, drithëra të plota.
2. Zbatoni «orarin e shkuarjes në banjë».
3. Mos e pengoni fëmijën të shkojë në banjë kur ka nevojë.
4. Mos përdorni mjete të tjera, pa këshillën e mjekut.



Nëse këto mjete nuk e ndryshojnë aspak gjendjen,  
Nëse fëmija vjell ose dhembjet e tij janë intensive,  
**Thërrisni pediatrin.**

## Zënia e frymës

Frymëmarrja është e vështirë (fëmija bën sforco për të gjetur ritmin e frymëmarrjes) dhe e zhurmëshme; nganjëherë buzët janë të mavijosura.

Nëse fëmija është në moshë të vogël (3 vjeç ose më pak) dhe fillon papritur të kollitet fortë, ndoshta **ka gëlltitur diçka që i ka ngelur keq**.



Kujdes mos lini sende të vogla (perla, komça, **kikirikë**, etj.) në vende ku mund të merren prej fëmijëve të vegjël.

Nëse fëmija ka ethe, ka jargë të shumta, nuk mund të gëlltisë lëngje, sepse ka **SHUMË** dhembje në grykë, ndoshta fjala është për një **infeksion të epiglotës** / gjuhëzës, dera e hyrjes e laringut (kujdes ky rast është me urgjencë jetësore!)

Nëse fytyra e tij është e fryrë dhe ai ka pllaka të kuqe mbi lëkurë, ai ka **reaksion alergjik**.

Fjala mund të jetë edhe për **dhembje laringu** të rëndë (në këtë rast kolla është e fortë dhe e përsëritur (shih f. 9), ose edhe për **astmë** apo bronkiolit.

### **Çfarë duhet bërë më parë?**

1. *Ruani qetësinë: humbja e gjakftohtësisë vetëm mund ta keqësojë gjendjen e fëmijës.*
2. *Mos provoni **në asnjë rast** të vini ndonjë send në gojën e fëmijës për të parë se çfarë po ndodh.*
3. *Nëse mendoni se fjala është për dhembje laringu apo bronkiolit, **uleni atë** në sallën e banjës dhe i hapni në maksimum robintetet për të bërë sa më shumë avull.*



Nëse fëmija kapërdin një send që i «ngecet keq»

Nëse duket se ka një infeksion të rëndë të «grykës» (p.sh. të epiglotës/gjuhëzës)

Në se kalon një krizë të rëndë astme

Nëse fjala është për laringjit por gjendja e fëmijës nuk përmirësohet pas 15 minutave qëndrimi në avull,

**Shkoni në spital me ambulancë (tel. 144).**

## Kllapia

Fëmija rrëzohet: ai nuk reagon dhe merr frymë në mënyrë të zhurmshme ; ndoshta bën lëvizje të ritmuara me njerën ose shumë gjymtyrë.

Fjala është për kllapinë, që mund të shkaktohet prej **etheve** (shih kllapia prej etheve f. 8), prej një goditjeje në kafkë ose prej epilepsisë.

### ***Çfarë duhet bërë së pari?***

- 1. Rini të qetë. Shumica e kllapive kalojnë vetvetiu pas 5 minutave dhe nuk e dëmtojnë trurin.*
- 2. Mos e lini fëmijën të lëndohet (duke goditur ndonjë send të fortë).*
- 3. Vendoseni atë shtrirë mbi ijë dhe zhvisheni.*
- 4. Nëse ka ethe, uljani ato (shih ethet f. 6), por mos i jepni kurrgjë nga goja fëmijës, kur ai është pa ndjenja.*



Nëse fëmija bie në kllapi për herë të parë, me apo pa ethe,

Nëse ai ka rënë edhe më parë në kllapi **pa ethe** dhe këto zgjasin më shumë se 10 minuta,

**Nëse kllapia vjen pas një goditjeje të fortë në kokë, thërrisni 144-ën.**



Nëse fjala është për rënie në kllapi me ethe për herë të dytë dhe gjendja e fëmijës nuk ju shqetëson,

**Merreni në telefon pediatrin brenda gjysmë-ditës.**

## Koma

Në një kohë kur normalisht fëmija është i zgjuar, ai duket sikur është në gjumë të thellë, me frymëmarrje të zhurmshme ose të çrregullt.

### **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Rrini të qetë dhe shtrijeni fëmijën në krah pasi ta keni zhveshur.
2. Tundeni me kujdes nga supet ose pickojeni në llapën e veshit për ta zgjuar.
3. Vëzhgoni frymëmarrjen e tij.



Nëse fëmija nuk përmendet,

**Thërrisni 144-ën.**

Nëse fëmija përmendet,

**Thërrisni pediatrin me urgjencë.**

## Intoksikimi (helmimi)



Për të shmangur intoksikimet, është mirë të merren masa parandaluese. Prandaj, mos lini produkte intoksikuese në vende ku mund të merren prej fëmijëve nën 5 vjeç; kini kujdes edhe jashtë banesës tuaj. Sendet që mund të jenë të rrezikshme për fëmijët: Në

Kuzhinë	produkt për heqjen e lëndës kalkere produkt për hapjen e lavapjatës produkt për larjen e teshave produkt për larjen e enëve dhe për makinën enëlarëse produkt për dezinfektim («ujë zhaveli»), etj.
Sallën e banjës	puçër pastrimi <b>ilçe</b> disa kozmetikë etj.
Tualete/WC	dezinfektues Deodorantë
Dhomë Gjumi	<b>ilçe</b> Produkte makillagi
Sallon	alkool benzinë llampash duhan etj.
Ballkon/garazh	bimë helmuese antizhel aenzinë arodukte për mirëmbajtjen e veturave
Punishte	produkte kimike për punë dore Fotografi
Kopsht	produkte për kopshtari bimë helmuese

Nëse prapseprapë aksidenti ndodh...

## **Çfarë duhet bërë së pari?**

1. Mos kërkoni me çdo kusht ta bëni të vjellë fëmijën pa këshillën e mjekut.
2. Përpiquni të mësoni:
  - se çfarë produkti ka kapërdirë
  - se ç'sasi ka kapërdirë
  - se në ç'orë ka ndodhur
3. Vëzhgoni nëse fëmija ka shenja anormale
4. Kujtoni peshën e **tij**



Sidoqoftë, merrni shpejt në telefon në kabinetin e pediatrit ose në Toxzentrum në Zyrih (tel. 145). Ata do t'ju bëjnë pyetjet e dhëna më sipër dhe do t'ju këshillojnë për trajtimin që i duhet bërë fëmijës dhe për qëndrimin që duhet mbajtur.

Vini re: nëse ju thonë të shkoni në spital, mos të jeni i vetëm / e vetme me fëmijën. Mos harroni të merrni me vete produktin bashkë me ambalazhin, atë që fëmija ka vjellë si dhe një legen.



Nëse fëmija është pa ndjenja,

**Thërrisni 144-en.**

## Aksidentet



Edhe në këtë fushë, është më mirë të merren masa parandaluese. Kujdes nga aparatet humidifikuese me avull të nxehtë, nga tiganët dhe xhezvet e mbushura me lëngje që ziejnë, nga prizat elektrike të zbuluara, nga pishinat ... por edhe nga shumë gjëra të tjera.



## Djegiet

### Çfarë duhet bërë së pari ?

1. Shpëllani shpejt gjatë dhjetë minutave pjesën e djegur me ujë të bollshëm të rrjedhshëm të ftohtë, pasi të zbulohet lëkura e dëmtuar, po qe e nevojshme.
2. I jepni paracetamol, që vepron edhe kundër dhembjes (dozimi f. 6).
3. Nëse veshjet e fëmijës janë duke u djegur, hidhni sipër ujë të ftohtë ose në mungesë mbështilleni fëmijën me mbulesë stofi **jo sintetike**.



Edhe nëse djegia është e sipërfaqshme ose sipërfaqia e prekur është e vogël,

**Merrni në telefon pediatri.**



Nëse djegia është e thellë ose e shtrirë, shkoni shpejt në spital.

- Vini Re. Djegia e fytyrës, e duarve ose e këmbëve, e organeve gjenitale duhet të shikohet patjetër prej mjekut.
- Mos vini kurrë yndyrë, pambuk hidrofil (ose pambuk steril) mbi plagë.
- Mos i shponi kurrë flluskat në shtëpi.


## Zënia prej korrentit

### Çfarë duhet bërë së pari?

1. Prejeni korrentin (rrymën elektrike) **para** se ta **prekni** fëmijën. Nëse kjo nuk është e mundur, përdorni një shkop (për shembull një bisht fshese; por jo metalik) për ta shkëputur fëmijën nga kontakti me korrentin. **Duart** duhet t'i keni të **thata**.
2. Vëzhgoni nëse fëmija është në vete (me ndjenja) apo jo. Nëse është pa ndjenja dhe ju dini se si bëhet reanimacioni, bëjeni atë.
3. Shikoni nëse fëmija ka djegie dhe nëse ka, i kaloni ato në ujë të ftohtë (shih djegiet f. 35).



Thërrisni 144-en duke vazhduar në të njëjtën kohë bërjen e reanimacionit, nëse fëmija është gjithnjë në vete (me ndjenja).



## Mbytja (në ujë)

### Çfarë duhet bërë më parë?

1. Nëse fëmija është në vete (me ndjenja), mbulojeni me mbulesë ose me veshje të thata, pasi ta keni zhveshur.



Nëse fëmija është pa ndjenja dhe nuk merr frymë, bëni me-njëherë reanimacionin nëse dini ta bëni dhe thërrisni 144-ën, duke vazhduar njëkohësisht bërjen e ranimacionit.

Vini Re: Nëse fëmija është në vete (me ndjenja), çojeni megjithatë në spital: mund të ndodhin ndërlikime disa orë pas mbytjes (në ujë).



# Fëmija që ushqehet me gji nga 0 deri në 3 muaj

Fëmija juaj:

- ka oreks të mirë
- nuk pështyn ose pështyn pak
- del jashtë një ose shumë herë në ditë
- nuk ka ethe (më pak se 38°)
- lëshon klithma me forcë

Kjo nuk duhet t'ju shqetësojë... edhe sikur ai...

- të mos pushojë së klithuri nga ora 19.00 deri në orën 22.00: kjo është e lodhshme por gjë që dihet
- të qajë duke i palosur këmbët në mënyrë ritmike: fjala është për kolike: kërkoni këshilla prej pediatrit për ta lehtësuar fëmijën
- të ketë pirë e të mos ketë dalë jashtë gjatë shumë ditëve: kjo është e mundur nëse ai pi vetëm qumështin e nënës: merrni kontakt me pediatrin nëse fëmija nuk ndjehet i qetë.

Por...

- nëse ai e ka tempertaurën mbi 38°
- nëse bëhet shumë i zbehtë
- nëse sjellja e tij është e pazakonshme (pikërisht nëse klithmat i ka të dobëta)
- nëse vjell shpesh, e me rrëke
- nëse e heq shumë barku dhe shumë shpesh (edhe kur ushqehet me gji)
- nëse këerthizën e ka të kuqe ose ngjyrë trëndafili me qelb



**Thërrisni shpejt pediatrin**

Botuar nga Shoqata zvicerane e Pediatrisë

Autorë: Dr. I. Germann-Nicod  
Dr. J. Racine Stamm  
Botimi origjinal: Vincent, Sophie et les autres...  
© 1995, Dr. I. Germann-Nicod

Botimi i 7-të, 2006

Përkthimi në shqip nga Kadri Çenko  
Vizatimet: Werbeatelier HP. & E. Meier, Bern  
Litografia: Prolith S.A., Köniz  
Radhitja dhe shtypi: S & Z Print AG, Brig-Glis



**ssp sgp**

**SWISS SOCIETY OF PAEDIATRICS**

Ihre Ärztinnen und Ärzte für Kinder und Jugendliche

Les médecins de vos enfants et adolescents

I medici dei vostri bambini e adolescenti